Kronikë

Tiranë/ Eksploziv banesës në katin e 9-të të një pallati, frekuentohej nga Bernard Sinomati, vëllai i 'Buzëderrit' të Vlorës! Policia gjeti sende personale dhe dokumente

Apartamenti ku pak para mesnatës së të dielës shpërtheu një sasi tritoli në ballkon në katin e nëntë në Tiranë frekuentohej nga personazhe të njohur për policinë. Burime bëjnë me dije se në të është parë të hyjë dhe dalë vazhdimisht Bernard Sinomati, vëllai i Sokol Sinomatit, buzëderrit të Vlorës.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
22 Dhjetor, 12:33 | **Përditësimi: 22 Dhjetor, 17:40**

Share

TIRANË - Një sasi eksplozivi është hedhur në një banesë në katin e 9-të të rrugës "Sadik Petrela" në kryeqytet.

Apartamenti ku pak para mesnatës së të dielës shpërtheu një sasi tritoli në ballkon në katin e nëntë në Tiranë frekuentohej nga personazhe të njohur për policinë. Burime bëjnë me dije se në të është parë të hyjë dhe dalë vazhdimisht Bernard Sinomati, vëllai i Sokol Sinomatit, buzëderrit të Vlorës.

Dyshohet se Bernard Sinomati bashkëjetonte me Elena Arzën, e cila e kishte marrë me qira banesën. Grupi hetimor dyshon se në momentin e shpërthimit, të dy kanë qenë brenda, por të jenë larguar menjëherë, dhe pasi kanë kaluar kaq orë, akoma nuk janë gjetur për t'u pyetur.

LEXO EDHE:
Makthi i trafikut, policia nga e hëna me plan operacional! Shërbimet 12 orë në ditë, rrugët me dyndje në monitorim

Brenda apartamentit janë gjetur sende personale dhe dokumente të vëllait të Buzëderrit. Bernard Sinomati dyshohet se ishte shënjestra e atentatit të këtij fillim viti në Vlorë, ku u eliminua me snajper nipi i tij, Gëzim Sinomati, djali i Sokol Sinomatit alias Buzëderri.

Ngjarja ka mbetur e pazbardhur, por dyshimet janë se Bernardi të ketë qenë shënjestër në atë kohë.

Policia e kryeqytetit informoi se rreth orës 23:45, të datës 21.12.2024, është njoftuar Salla Operative se në banesën që jetonte shtetasja Elena Arza, në rrugën "Sadik Petrela" në katin e 9-të, është dëgjuar një zhurmë si shpërthim.

> *"Menjëherë kanë shkuar shërbimet e Policisë ku kanë hapur me forcë derën pasi nuk kishte njëri në banesë dhe kanë konstatuar në ballkonin e kësaj banese, të dëmtuar xhamin dhe vetratën e ballkonit, që dyshohet se janë dëmtuar nga lëndë plasëse"*

Dyshohet se lënda plasëse është hedhur me dron, por banesa rezulton në emër të Albert Thoma, i cili ia ka lëshuar banesën me qira Elena Arzës.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:30

Tiranë/ Detaje të reja nga eksplozivi në ballkonin e katit të 9 të një pallati: Aty hynte dhe dilte vazhdimisht Bernard Sinomati, vëllai i 'Buzëderrit' të Vlorës

Apartamenti ku pak para mesnatës së të dielës shpërtheu një sasi tritoli në ballkon në katin e nëntë në Tiranë frekuentohej nga personazhe të njohur për policinë. Burime bëjnë me dije se në të është parë të hyjë dhe dalë vazhdimisht Bernard Sinomati, vëllai i Sokol Sinomatit, buzëderrit të Vlorës, sipas raportimeve të gazetarit Sokol Dema.

Dyshohet se Bernard Sinomati bashkëjetonte me Elena Arzën, e cila e kishte marrë me qira banesën. Grupi hetimor dyshon se në momentin e shpërthimit, të dy kanë qenë brenda, por të jenë larguar menjëherë, dhe pasi kanë kaluar kaq orë, akoma nuk janë gjetur për t'u pyetur.

Brenda apartamentit janë gjetur sende personale dhe dokumente të vëllait të Buzëderrit. Bernard Sinomati dyshohet se ishte shënjestra e atentatit të këtij fillim viti në Vlorë, ku u eliminua me snajper nipi i tij, Gëzim Sinomati, djali i Sokol Sinomatit alias Buzëderri.

Ngjarja ka mbetur e pazbardhur, por dyshimet janë se Bernardi të ketë qenë shënjestër në atë kohë.

G.K/Shqiptarja.com

Share

S.G/G.K/Shqiptarja.com

TAG: buzëderri i Vlorës | bernard sinomati | Elena Arza | sokol sinomati | shpërthim | Tirana

Komento

Komente

Turi: 22/12/2024 13:12
Duhet ber ligj kush kapet me lende eksplozive duhet te denohet per terrorizem me burgim te perjetshem e formes se prere se kjo lloj egersire qe jeton ne kete vend nuk mbledhet ndryshe
Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
21 Dhjetor, 15:03
Si e vlerësoni mbylljen e TikTok në Shqipëri për një vit?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Hapet tregu i gjelave të deitit në Bulqushk, apeli i kryebashkiakut Veliaj: Konsumoni produktet lokale për të ndihmuar familjet e zonës
22 Dhjetor, 12:12

Tiranë, arrestohet taksisti, akuzohet se i mori me dhunë klientit një shumë parash dhe 2 telefona
22 Dhjetor, 10:35

Mediat ndërkombëtare jehonë lajmit për mbylljen e TikTok në Shqipëri
21 Dhjetor, 19:10

Ylli Pata: Pse Berisha zgjodhi bllokojë rrugët para Krishtlindjeve?

Ylli Pata
21 Dhjetor, 18:24

Trafiku në Tiranë, eksperti: Problem menaxhimi i rrugëve! Propozimet për zgjidhje, parkime jashtë Unazës së Vogël e sinjalistikë e përkohshme
21 Dhjetor, 12:30

Nata e dytë e Fest 63, 15 artistë të tjerë ngjiten në skenë
20 Dhjetor, 20:50

Konfirmimi i prokurores Eranda Laze ankimohet në Kolegj
20 Dhjetor, 19:41

5 vite SPAK/ Romeo Kara në Report Tv: Berisha sfida kryesore! Jo heqje non gratash, por shpallje të reja! Shabani: Saliu e Meta të akuzuar se kanë porositur vrasje
20 Dhjetor, 19:19

Të çash trafikun në Tiranë, 'mision i pamundur'! 'Paralizohen' rrugët, radhë të gjata mjetesh edhe në autostradën Tiranë - Kashar (VIDEO)
20 Dhjetor, 17:32

U zbulua në Rinas, ilaçi për ftohje a po trafikohet për të përzierë drogën?

Sokol Dema
20 Dhjetor, 17:25

Goditën me sende të forta 34 vjeçarin, arrestohen 2 të rinjtë në Tiranë
20 Dhjetor, 15:38

Konferenca e Solidaritetit Islamik, Veliaj pret Sekretarin e ISSA-s dhe presidentin e KOKSH: Më shumë partneritet për sportin
20 Dhjetor, 14:45

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje